



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/44

Datë: 12.08.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 12 gusht 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# **KONCEPT-DOKUMENT**

---

## **PËR INVESTIME STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**10 gusht 2015**

## KONCEPT DOKUMENT

### PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

#### 1. Hyrje

Ky koncept-dokument është përgatitur në pajtim me Udhëzimin për Përgatitjen e Koncept-Dokumenteve dhe Memorandumeve Shpjeguese nr. 074/2012 të datës 19 mars 2012, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011.

Projektligji për Projektet për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës nuk është pjesë e planit vjetor të punës, megjithatë duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekonomik vlerësohet si një projekt me prioritet të lartë.

Arsyeja kryesore për prioritetin e lartë të Projektligjit për Investimet Strategjike në Republikën e Kosovës është fakti se nëpërmjet të këtij projektligji eliminohen barrierat penguese të deritanishme për nxitjen dhe realizimin e investimeve të huaja, si burokraci e tepërt, procedurat e stërzgjatura, mungesa e transparencës, infrastruktura ligjore jo e favorshme, të cilat kanë penguar dhe vështirësuar realizimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës. Kështu që, në mënyrë që të arrihet një rritje ekonomike dhe rritje e punësimit është esenciale që Projektligji për Investimet Strategjik të procedohet për miratim në Parlamentin e Republikës së Kosovës sa më shpejt.

#### 2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes kryesore

Ky projektligj është iniciativë e Qeverisë së Republikës së Kosovës në kuadër të zbatimit të programit qeveritar për nxitjen dhe mbështetjen e investimeve strategjike të huaja në Kosovë, në fushat e ekonomisë së vendit që paraqesin potencial të lartë zhvillimor. Nëpërmjet këtij projektligji përcaktohen procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese, në funksion të arritjes së qëllimit kryesor për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në sektorët e ekonomisë të përcaktuar me këtë projektligj.

Ky projektligj do të zbatohet për të gjitha investimet strategjike, që përzgjidhen si të tilla në bazë të kriterëve dhe sipas procedurave të përcaktuara në të dhe në ata sektorë ekonomik të përcaktuar shprehimisht nga ky projektligj si sektorë të investimeve strategjike. Nëpërmjet stimulimit të investimeve strategjike, do të mobilizohet kapitali financiar i investitorëve i cili do ta mbështes zhvillimin e veprimtarisë prodhuese sipas sektorëve të përcaktuar me këtë projektligj.

### **2.1. Situata Ekzistuese**

Aktualisht, institucionet e Republikës së Kosovës kanë vështirësi të shumta për të nxitur dhe tërhequr investimet strategjike vendase dhe të huaja. Këto vështirësi janë si pasojë e procedurave të pafavorshme, te gjata dhe të komplikuar për realizimin e investimeve të huaja në Kosovë dhe procedurave të komplikuar për bartjen e të drejtës të shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj.

Vendet fqinje me të cilat Republika e Kosovës është në garë të drejtpërdrejt për tërheqjen e investimeve të huaja kanë legjislacion më të favorshëm për tërheqjen e investimeve të huaja dhe për bartjen e pronës shtetërore tek investitorët e huaj. Kjo për shkak se legjislacioni i vendeve fqinje të Kosovës parasheh procedura më të thjeshta për bartjen në shfrytëzim të pronës shtetërore tek investitorët e huaj dhe atë me çmime shumë simbolike, dhe pa pasur nevojë për hapjen e procedurave tenderuese.

Pasi ky ligj do të hyjë në fuqi do të eliminohen pengesat për tërheqjen e investimeve të huaja dhe do t'i jap të drejtë Kuvendit të Kosovës që ta autorizojë Qeverinë e Kosovës që të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës shoqërore dhe publike tek investitorët e huaj pa pasur nevojë për hapjen e procedurave tenderuese, por me kusht që të plotësohen kriteret të cilat janë të parapara me këtë draft ligj.

### **3. SYNIMET DHE OBJEKTIVAT QË NDËRLIDHEN ME PRIORITETET E QEVERISË**

Siç u përcaktuar me lartë ky projektligji përcaktohen procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përsheptuese, në funksion të arritjes së qëllimit kryesor

për nxitjen, tërheqjen dhe realizimin e investimeve të huaja në sektorët e ekonomisë të përcaktuar me këtë projektligj.

Në projektligj trajtohen kriteret për përcaktimin e një investimi strategjik, si vlera e përgjithshme e investimeve; hapja e vendeve të reja të punës; ofrimi i teknologjive të reja për të rritur konkurrueshmërinë dhe efektivitetin e investimeve; rritja e nivelit dhe cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtja e mjedisit dhe konsumatorit.

Më këtë projektligj përcaktohet themelimi i Komisioni për Negocimin e Marrëveshjeve për Investime Strategjike. Komisioni për Negocimin e Marrëveshjeve për Investime Strategjike themelohet me vendim të Qeverisë si organ për negocimin, lidhjen dhe shkëputjen e marrëveshjeve për investime strategjike.

Ky Komision kryen veprime të cilat kanë për qëllim pranimin dhe identifikimin e projekteve për investime strategjike, i ofron Qeverisë rekomandime në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të gjitha aktivitetet që lidhen me tërheqjen e Investimeve të huaja përmes negociatave të drejtpërdrejta dhe ofron rekomandime për negocimin, lidhjen dhe shkëputjen e marrëveshjeve për investime strategjike.

Gjithashtu, ky Komision ka për obligim që të sigurojë Qeverinë se lidhja e një Marrëveshje për Investime Strategjike nuk do të rezultojë në shkeljen e ndonjë ligji ose marrëveshjeje ndërkombëtare me të cilat Kosova përpiqet të harmonizojë legjislacionin e saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

#### **KAPITULLI 4: OPSIONET**

##### ***Opsioni 1: Opsioni i status-quo (pa ndryshim)***

Lënia e gjendjes aktuale të pandryshuar do të thotë që vendet fqinje me të cilat Republika e Kosovës është në garë të drejtpërdrejtë do vazhdojnë të kenë legjislacion me të përshtatshëm për tërheqjen dhe nxitjen e investimeve të huaja. Rrjedhimisht, si rezultat i këtyre pengesave, investitorët e huaj do ta vazhdojnë të anashkalojnë Kosovën dhe do të derdhin kapitalin e tyre financiar në vendet fqinje.

Mos-ndryshimi i politikave legjislative aktuale lidhur me tërheqjen dhe nxitjen e investimeve të huaja apo vazhdimi i gjendjes aktuale pa e nxjerr ligjin mbi investimet

strategjike, do të nënkuptonte vazhdimin e status quo-s, hezitimin e investitorëve të huaj për të investuar në Kosovë, vazhdimin e gjendjes së tanishme, e rrjedhimisht edhe mos fuqizimin e ekonomisë vendore dhe mos-avancimin e sektorit të prodhimit dhe eksportit jashtë vendit.

### ***Opsioni 2: Miratimi i ligjit të ri për Investime Strategjike***

Siç u shpjegua më lartë dhe siç do të sqarohet në vijim, Ligji për Investimet Strategjike është i domosdoshëm për të rregulluar dhe përmirësuar fushën e nxitjes dhe promovimit të investimeve të huaja. Miratimin i këtij ligji do të eliminon të gjitha barrierat për tërheqjen e investimeve të huaja, ashtu që do t'i jap të drejtë Kuvendit të Kosovës që ta autorizojë Qeverinë e Kosovës të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës shtetërore të Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj, pa pasur nevojë për hapjen e procedurave tenderuese, por me kusht që të plotësohen kriteret të cilat janë të parapara me këtë draft ligj.

### ***Opsioni 3: Miratimi i ligjit të ri për Investime Strategjike por me kompetenca me të gjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës.***

Një opsion tjetër që është trajtuar, ka qenë hartimi i Projektligjit për Investime Strategjike, i cili do të përmbante dispozita të tilla ligjore, në bazë të të cilave Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të kishte nevojë që të kërkojë autorizim nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj.

## **KAPITULLI 5: ANALIZA E OPSIONEVE**

### ***Përparësitë:***

**Opsioni 1:** Nuk ka ndonjë përfitim të parashikueshëm.

**Opsioni 2:** Projektligji për Investime Strategjike përcakton procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj, në funksion të arritjes së qëllimit kryesor për tërheqjen e investimeve të huaja në sektorët e ekonomisë të përcaktuar me këtë projektligj.

Miratim i Ligjit për Investim Strategjike do të ketë ndikime të mëdha fiskale. Vlerësohet që rritja e investimeve të huaja do të ndikojë në rritjen e qarkullimit financiar në ekonominë e Kosovës. Pjesa më e madhe e këtij qarkullimi do të vijë nga rritja prodhimitarisë vendore, eksporteve dhe krijimit të vendeve të reja të punës, të cilat do të ndikonin në rritjen e të hyrave buxhetore dhe përmirësimin e bilancit tregtar të ekonomisë të Kosovës.

**Opsioni 3:** Nuk është i favorshëm për shkak se aprovimi i një ligji të tillë, do të jetë në konflikt të drejtpërdrejt me Ligjin Nr. 4/L-034 mbi Agjencinë Kosovare Privatizimit dhe Ligjit 2003/3 për Agjencinë Pyjore të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar dhe si i tillë do të ndikojë në thellimin e pasigurisë juridike në Kosovë.

***Pasojat negative:***

**Opsioni 1:** Mosveprimi do të ndikojë në humbjen e mundësive të shumta për tërheqjen e investimeve të huaja, e si rrjedhojë do të ndikojë në humbjen e qindra miliona eurove të cilat mund t'i përfitojë ekonomia e Kosovës përmes tërheqjes së investimeve të huaja. Aprovimi i Projektligjit për Investime Strategjike, do të krijojë rritje në qarkullimin financiar, shit-blerje, vende të reja pune, eksporte, tatime në të hyra, kështu që mund të konsiderohet që mos miratimi i këtij një ligji do t'i kushtojnë Ekonomisë të Kosovës me humbje të mëdha të investimeve dhe tatimeve të parrealizuara.

**Opsioni 2:** Sipas informatave në dispozicion dhe konsultimeve me palët e përfshira, nuk ka ndonjë pasojë të parashikuar negative të miratimit të ligjit të ri për Investime Strategjike.

**Opsioni 3:** Miratimi i Ligjit për Investime Strategjike me dispozita ligjore që do t'i jepnin të drejtë Qeverisë të bartë të drejtën e shfrytëzimit të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët e huaj, pa pasur nevojë aprovimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, do të mund të ngjallë kundërtënie, për shkak se mund të jetë në konflikt me legjislationin në fuqi.

***Kostoja:***

Implementimi i këtij projektligji nuk ka ndonjë ndikim financiar në buxhetin e Republikës së Kosovës (në shtimin e nr. të shërbyesve civil apo shpenzime buxhetore të institucioneve të Kosovës) mirëpo tërheqja e investimeve të huaja në Kosovë nga implementimi i këtij Projektligji do të ketë ndikim të madh në rritjen e të hyrave buxhetore dhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Kosovës. Është jetike që Ligji për Investime Strategjike të miratohet këtë vit ashtu që Kosova të fillojë sa më shpejt të përfitojë nga investimet e huaja, gjë që kërkon që ligji të hartohet dhe të shpallet sa më shpejt që është e mundur.

## **KAPITULLI 6: KONSULTIMET**

Palët kryesore që janë konsultuar janë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Integritetit Evropian, organizatat e shoqërisë civile, odat ekonomike etj.

## **KAPITULLI 7: KRAHASIMI I OPSIONEVE**

Nga të tre opsionet e identifikuar:

*Opsioni 1* – nuk rekomandohet pasi që mund të merret parasysh se në rast të mosveprimit, do të rezultojë në humbjen e qindra miliona eurove, mijëra vendeve të reja të punës, miliona eurove në eksporte, si dhe miliona eurove në tatime që do të arriheshin përmes realizimit të investimeve të huaja.

*Opsioni 2* – është opsioni i preferuar, sepse aprovimi i Ligjit mbi Investimet Strategjike do të lehtësonte në masë të madhe rritjen e investimeve të huaja në Kosovë. Për më tepër, rritja e investimeve nga investitorët e huaj do të çojë drejt rritjes së punësimit, eksporteve, prodhimit vendor, e përfundimisht do të ndikojë në rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të ekonomisë së Kosovës.

*Opsioni 3* – nuk është opsioni i preferuar, për arsyet e përshkruara në analizën e opsioneve.

## **KAPITULLI 8: ARSYETIMI I PROPOZIMIT**

Ligji Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja i ofron investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin atyre siguri që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Mirëpo, përkundër garancive të cilat ofrohen me Ligjin mbi Investimet e Huaja, qindra investitorë të huaj nuk po arrijnë të plasojnë kapitalin e tyre financiar në Kosovë për shkak të procedurave të pafavorshme, të stërzgjatura dhe të komplikuar për realizimin e investimeve. Kjo është pengesë për rritjen ekonomike dhe punësimin në Kosovë, e cila duhet tejkaluar urgjentisht. Ligji mbi Investimet Strategjike do të nxisë në masë të madhe rritjen e investimeve të huaja nga investitorët e huaj, duke ndihmuar kështu në tejkalimin e kësaj pengese. Rritja e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës do të çojë drejt rritjes së prodhimit vendor, rritjes së punësimin, rritjes së eksporteve, e përfundimisht edhe tek rritja e buxhetit të Kosovës, i cili do të ndodh përmes arkëtimit të tatimeve në ardhurat e korporatave dhe në të ardhurat personale.

## **KAPITULLI 9: REKOMANDIMI**

Pas shqyrtimit të tre opsioneve për zgjidhjen e kësaj çështje, ne rekomandojmë që Qeveria të miratojë këtë koncept-dokument dhe të zgjedhë Opsionin 2 (miratimi i një ligji të veçantë për projektet në investimet strategjike) si opsioni më i favorshëm për të arritur synimet e përshkruara me këtë koncept-dokument.

Me qëllim të eliminimit të pengesave në tërheqjen dhe realizimin e investimeve të huaja në Kosovë është e nevojshme të përshpejtohet procesi i miratimit të Ligjit për Investime Strategjik.

Miratim i Ligjit për Investimet Strategjike do të jetë shumë i dobishëm për ekonominë e Kosovës pasi që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e qarkullimit financiar dhe të hyrave buxhetore. Publiku do të përfitojë përmes rritjes së aktiviteteve ekonomike, ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të kryera në Kosovë si dhe në rritjen e vendeve të reja të punës të krijuara nga tërheqja e investimeve të huaja. Kosova përfundimisht

do të përfitojë nga rritja e prodhimit, përmirësimi i bilancit tregtar, rritja e punësimit, rritja e tatimeve në të ardhura të korporatave, etj.